

VENDIM
Nr.1239, datë 10.9.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS MEMALIAJ FSHAT, TË QARKUT TË GJIROKASTRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Memaliaj Fshat, të qarkut të Gjirokastrës, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Memaliaj Fshat, të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me vendimin nr.5, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Fushë-Memaliaj, të qarkut të Gjirokastrës”.

2.Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Memaliaj Fshat për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Memaliaj
nr.1

Lidhja

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
14,15	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
10-13	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë	Në pronësi
16-24	Varrezat publike	Në pronësi
25-31,35-45,58,59,66,68,71, 75,77,89-92	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
32-34,46-57,60-65,67,69,70, 72-74,76,78-88,158-357	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike.).	Në pronësi
358-360	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
130-132,134-136,138, 139,141-147,149-151, 153,154,156,157	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim

107,112, 121,122, 124,128, 129, (vetëm kanalet e treta) 133,137,140,148,152,155	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
---	---	------------